



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 6436 Prot

Peshkopi, më 22.09.2022

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Diber

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Diber Nr.78

Data: 16.09.2022

“Për një shtesë në Vendimin nr.46 datë 03.06.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Diber, Instrukcioneve në vartësi dhe të Njërive Administrative për vitin 2022”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Afrim Mikli





FASHKËJA PESHKOPË
Nr. 923/1 Prot. Peshkopë
Mbarimi Di 28/09/22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.923/1.prot.

Peshkopi, më 27.09.2022

Lënda : Per vendimin nr. 78, datë 16.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISË DIBËR

P E S H K O P I

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.78, date 16.09.2022 “Për një shtese në VKB nr.46, datë 03.06.2022 për miratimin e numrit të punonjesve të administrates së bashkisë Dibër, institucioneve në vartësi dhe të Njesive Administrative për vitin 2022 “, vendosa :

Të miratojë në parim vendimmarrjen e lartëcituar që bën pjesë në fushën e kompetencave të veta të NJQV , në kushtet e zbatimit rigoroz të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në atë fushë të së drejtës, veprime që kurdoherë janë përgjegjesi direkte administrativoligjore e strukturave përgjegjëse që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 78 Datë 16/09/2022

“Për një shtesë në Vendimin nr.46 datë 03.06.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2022”.”

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, pika dh, në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.64 datë 24.12.2021 “Për miratimin e Numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në vartësi dhe Njësive Administrative për vitin 2022, i ndryshuar”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **16.09.2022** me 18 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e shtesës në vendimin nr.46 datë 03.06.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucionëve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2022.
2. Shtimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Dibër me 20 (njëzet) pozicione me kontratë pune të përkohëshme mujore (3-6 muaj) për punë sezonale sipas relacionit bashkangjitur.
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

DREJTORIA E SHERBIMEVE MBESHETTESE

PROJEKT-VENDIM

Nr. 05 Date 10/09/2022

“Për një shtesë në Vendimin Nr.46 datë 03.06.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në varësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2022”

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, pika dh,në Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligji nr 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.64 datë 24.12.2021 “Për Miratimin e Numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në varësi dhe Njësive Administrative për vitin 2022.V Nr.64 datë 24.12.2021 “Për Miratimin e Numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në varësi dhe Njësive Administrative për vitin 2022” I ndryshuar

KËRROJMË:

- I. Një shtesë në vendimin Nr.46 datë 03.06.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në varësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2022”
- II. Shtimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Dibër me 20 (njeteze) pozicione me kontratë pune të përkohshme mujore (3-6 muaj) për punë sezonale sipas relacionit bashkangjitur.
- III. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:

Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore

Malbora Lala

Drejtori Ekonomik

Mensur Shehi

Përgjegjëse e Sektorit Juridik

Elona Lusha

KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU



Adresa: Bulevardi “ELEZ ISUFI”, Peshkopi, email:bashkiadiber@gmail.com Nr.tel:0695521822935



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

DREJTORIA E SHËRBBIMEVE MBËSHTETËSE
RELACION

Me të dhëna të grupuara, për një shtesë në Vendimin Nr.64 datë 03.06.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Insitucioneve në vartësi dhe të Njërive Administrative për vitin 2022”

KËSHILLIT TË BASHKISË DIBËR

Në zbatim të dispozitave të ligjit.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, “*Detrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak*” pika “dh”, citohet “*miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njëjësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë; Kërkojnë nga ana tjetër shtimin e numrit të punonjësve sezonal me 20 pozicione për një periudhë 3-6 muajore si pasojë e kërkesave të ardhura pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore .*

Njësitë Administrative për mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve gjatë sezonit të dimrit kërkojnë personel shtesë per **20 punonjes sezonal**.

Bashkia Dibër ka si mision të ofrojë shërbime publike të vazhdueshme e të përmirësuara për të gjithë komunitetin e bashkisë Dibër ,të ngrejë në nivelin e kërkesave të kohës, interesave dhe kulturës qytetare të gjitha shërbimet publike, të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e jetës së qytetarit.

Prane Bashkisë Dibër marrim shkresa/kërkesa të vazhdueshme nga qytetarë kryesisht të zonave rurale molare në lidhje kërkesat dhe nevojat për punëtorë në rrugë sidomos gjate muajve te dimrit per shkak terrenit dhe vështiresive me bllokimin e rrugëve që vijnë nga reshjet e shumta gjate dimrit, si dhe shtrirjen me shërbim në këto zona sa i përket menaxhimit të situatave gjate sezonit te dimrit . Punonjësit që kemi në organikën e derianishme nuk mjaftojnë për plotësimin e kërkesave të qytetarëve. Në këto kushte dhe duke u gjendur përpara kërkesës së vazhdueshme nga qytetarët për t’iu ofruar shërbimet e kërkuara kryesisht në sezonin e Dimrit dhe për tu ofruar këto shërbime përveç materialeve e mjeteve specifike duhet të na mundësoni një numër shtesë punonjësish sezonal prej **20 punëtorë**.

Shuma Totale e punonjesve te jete 900 (nenteqind) sipas tabelës së mëposhtme:

Funksioni	Ishte	Bëhet
Punonjes te Administrates	486	486
Institucione ne Varesi	74	74
Funksione te Deleguara	260	260
Punonjes Sezonal me Kontrata 3-6 Muaj	60	80
Shuma Totale M.B.NJ	880	900

Punonjës Sezonal do të jenë më shumë në numër. Nga 60 punonjës që janë aktualisht kërkojmë të bëhen 80 punonjës .Shtesa prej 20 punonjësish specifikohet si më poshtë:

- Për nevojat e Njësive Administrative për Mirëmbajtjes dhe rehabilitim e Rrugëve gjate sezonit te dimrit kërkojmë punësimin e **20 punonjësve** sezonal.

Me qëllim rritjen e efikasitetit dhe përdorimit sa më racional të burimeve njerëzore është e domosdoshme shtimi i numrit aktual të punonjësve sezonal duke i dhënë përparësi ofrimit të shtërbimeve publike dhe shmangjen e problemeve nga mungesa e personelit .

Duke shpresuar në mirëkuptimin e anëtarëve të Këshillit Bashkiak për një shtesë në Vendimin Nr.64 datë 03.06.2022 “Për miratimin e numrit gjithsejt të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2022” .

Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore

Malbora LALA

